



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1415 . prot

Tepelenë, më 07. 08.2025

✦ **RAPORT MBI REALIZIMIN E PLANIT TË AKTIVITETEVE TË KËSHILLIT
BASHKIAK TEPELENË**

📅 Janar – Qershor 2025

📍 Këshilli Bashkiak Tepelenë

Në zbatim të Vendimit nr. 66, datë 31.10.2024, “Për miratimin e Planit të Punës, Planit të Konsultimeve Publike dhe Planit të Buxhetit të Këshillit Bashkiak për vitin 2025”, ju prezantojmë raportin e realizimit për 6-mujorin e parë të vitit, që mbulon periudhën janar – qershor 2025.

Ky raport pasqyron punën, angazhimet dhe rezultatet e arritura në përmbushje të detyrimeve institucionale dhe në shërbim të qytetarëve të Bashkisë Tepelenë.

♦ **Mbledhjet e Këshillit Bashkiak**

Gjatë periudhës janar–qershor 2025 janë zhvilluar **7 mbledhje të Këshillit bashkia nga të cilat 1 mbledhje jashtë rradhe**

♦ **Vendimmarrja**

Gjatë periudhës janar–qershor 2025, Këshilli Bashkiak Tepelenë miratoi gjithsej **37 vendime**:

- 13 vendime me karakter normativ
- 24 vendime me karakter individual

Vendimet preken fusha të ndryshme, duke përfshirë:

- Miratimin e raportit vjetor të zbatimit të buxhetit për vitin 2024, ndryshimet në buxhetin vjetor
- Ndihmën ekonomike për familjet në nevojë nga fondet e kushtëzuara dhe fondet e Bashkisë
- Miratim bonus qiraje
- Miratim i programeve të strehimit, rikonstruksionin e banesave ekzistuese

- Miratimin I drafti të parë të PBA.
- Dhënie e titujve nderi dhe vendosjen e busti.
- Miratim për bashkëpunimin ndërkufitar në kuadër të AOOS-VJOSA
- Miratim për përcaktimin e terminalit të autobusëve në Bashkinë Tepelenë, etj.

♦ **Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme**

Komisionet e Këshillit kanë zhvilluar gjithsej **8 mbledhje**, të ndara si më poshtë:

- Komisioni për Ekonominë dhe Financat, Shërbimet Publike – 7 mbledhje
- Komisioni për Arsimin Kulturën Spotin 1 mbledhje

♦ **Aktivitetet dhe Dëgjesa Publike**

Janë organizuar **1 dëgjese publike**, në funksion të transparencës dhe përfshirjes qytetare, të fokusuara në:

- Investimet publike,

♦ **Raportimet nga Drejtoritë e Bashkisë**

Kane raportuar në Këshill drejtoritë e Bashkisë sipas planit të punës, duke paraqitur ecurinë e realizimit të detyrave dhe aktiviteteve të tyre për 6-mujorin e parë të vitit 2025. Raportimet përfshijnë informacion mbi sfidat e hasura, masat e ndërmarra dhe rezultatet e arritura në zbatim të objektivave të përcaktuara, duke siguruar kështu transparencë dhe llogaridhënie para Këshillit dhe qytetarëve.

♦ **Anketimi për Vlerësimin e Punës së Këshillit gjatë vitit 2024**

Është zhvilluar një anketë vlerësimi me qytetarët, e cila ka synuar të masë perceptimin mbi transparencën, efikasitetin dhe përfaqësimin e interesit publik nga ana e Këshillit.

♦ **Raporti i Performancës së Këshillit për vitin 2024**

Ky raport është hartuar dhe miratuar në fillim të vitit 2025. Ai përmbledh punën e Këshillit gjatë vitit të kaluar, duke përfshirë sfidat dhe arritjet, si dhe rekomandime konkrete për përmirësim e punës.

♦ **Buletini Vjetor i Këshillit Bashkiak për vitin 2024**

Është publikuar buletini vjetor me përmbledhjen e veprimtarisë së Këshillit gjatë vitit 2024, si një mjet transparence dhe informimi për qytetarët.

Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2025, u përditësuan dhe mbajtën në mënyrë të rregullt regjistrat e kërkesave dhe ankesave, regjistri i konsultimeve publike dhe regjistri i mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.

U realizua transmetimi live i mbledhjeve të Këshillit për të garantuar transparencën dhe përfshirjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

Janë trajtuar gjithsej 15 kërkesa dhe ankesa nga qytetarët.

Gjithashtu, u organizua një sesion informues për qytetarët, ku u shpjegua funksionimi i Këshillit dhe rëndësia e përfshirjes së tyre në proceset vendimmarrëse.

♦ **Realizimi i Buxhetit të Këshillit Bashkiak për 6-Mujorin e Parë 2025**

Nga fondi i akorduar për veprimtarinë e Këshillit Bashkiak për vitin 2025, për periudhën janar-qershor është realizuar **48% e buxhetit të planifikuar vjetor**. Shpenzimet janë kryer në përputhje me planin vjetor të aktiviteteve dhe kanë mbuluar:

- Ndërtimi i një këndi lojërash për fëmijët pranë kopshtit “Murat Koçiu” – një nismë e Këshillit Bashkiak (400,000 lekë)
- Rimbursimi i shpenzimeve të transportit për nxënësit e Njesisë Administrative Lopës që ndjekin shkollën në qytetin e Tepelenës – për të parandaluar braktisjen shkollore (456,000 lekë)
- Hartimi i materialeve zyrtare dhe mbulimi i kostove logjistike e funksionale për mbarrëvajtjen e punës së Këshillit Bashkiak (100,000 lekë)

Këshilli Bashkiak Tepelenë mbetet i përkushtuar për të vijuar punën me transparencë, llogaridhënie dhe përfaqësim të denjë të qytetarëve në çdo proces vendimmarrës.

SEKRETAR I KËSHILLIT

Valbona ÇELA

